



Shkurtimisht për:

Ekosistemi i mbështetjes së
inovacioneve dhe draft-ligji për
inovacion dhe ndërmarrësi

Janar 2025

HYRJE¹

Për një vend si Kosova, investimi në inovacion është jetik për ndryshimin e konfiguracionit ekonomik dhe rritjen e konkurrueshmërisë, duke trajtuar njëkohësisht disbalancet si deficitin e lartë tregtar. Kjo është esenciale për krijimin e kushteve për zbatimin e strategjisë për zhvillimin industrial dhe të biznesit, e cila është miratuar në vitin 2023. Kombinimi i këtyre përpjekjeve me përmirësimet në legjislacion dhe mbështetjen e fondeve për inovacion krijon një ambient më të favorshëm për kërkimin dhe zhvillimin në Kosovë. Një gjë e tillë, jo vetëm që do të ndihmojë në rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike, por edhe në ndërtimin e një ekonomie më të qëndrueshme dhe më të zhvilluar. Infrastruktura institucionale për kërkime dhe inovacion në Kosovë është në një fazë fillestare të zhvillimit me një qasje ad hoc për planifikimin e kërkimeve dhe menaxhimit jo-sistematik të politikave të kërkimeve, si dhe mungesë të konsideratës së duhur për tablonë e gjerë të ekonomisë dhe planifikimit afatgjatë.²

Përballë kësaj situatë, në kuadër të aktiviteteve të rregullta avokuese, Instituti Riinvest përmes platformës Green Action Space në fund të muajit qershor të vitit të kaluar kishte organizuar një diskutim në panel ku janë trajtuar në mënyrë të thelluar sfidat dhe mundësitë e ekosistemit të mbështetjes së inovacioneve në Kosovë. Ky dokument përmbledh në mënyrë telegrafike disa nga çështjet kryesore që janë trajtuar në këtë diskutim.

INOVACIONI DHE NDËRMARRËSIA NË KOSOVË

Gjendja aktuale e inovacionit dhe ndërmarrësisë në Kosovë është përballur me sfida të mëdha, duke përfshirë një kornizë ligjore që nuk është ende e ndërtuar dhe operacionalizuar plotësisht për zbatim. Draft-ligji i ri për inovacione dhe ndërmarrësi, i prezantuar në dhjetor 2023, ka pësuar ndryshime kualitative të rëndësishme, megjithatë ende mbetet hapsirë e konsiderueshme për përmirësim për ta bërë atë më efektiv. Korniza ligjore aktuale përbëhet nga Ligji për Kërkime Shkencore dhe Inovacione dhe Ligji për Inovacione Shkencore. Për më tepër, ekziston edhe Programi Kombëtar për Kërkime Shkencore (PKSH) 2023-2028, i cili për më shumë se një vit ka mbetur në procedura parlamentare dhe ende nuk ka filluar zbatimin. Një nga problemet themelore është mungesa e agjencive për zbatimin operativ të politikave dhe procedurave të mbështetjes. Konkretisht, me këtë çështje merren dy departamente: Departamenti për Kërkime Shkencore dhe Inovacione në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) dhe në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). Megjithatë, këto departamente nuk kanë një infrastrukturë të plotë mbështetëse në aspektin e politikave, procedurave dhe institucioneve që duhet t'i zbatojnë në mënyrë të pavarur nga ministritë.

Për më tepër, investimet në Kërkim dhe Inovacion (K&I) nga buxheti dhe burime të tjera publike mbeten të ulëta. Ligji ekzistues kërkon që 0.7% e buxhetit të përgjithshëm të qeverisë të dedikohet për K&I, por alokimet aktuale financiare janë dukshëm nën këtë nivel. Në fakt, me parashikimet në PKSH të paraqitura në tabelën më poshtë, nuk pritet që kjo të arrihet dhe që situata të ndryshojë

¹ Publikuar nga Instituti Riinvest në kuadër të projektit Horizon Europe (HE) “Policy Answers” (Politikat që japin përgjigje). Ky dokument është nxjerrë nga seria e debateve ‘Green Talks’ të projektit Green Action Space, iniciativë e përbashkët e Institutit Riinvest dhe fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja e këtij publikimi janë përgjegjësi e Institutit Riinvest.

² Regional Cooperation Council (2022). Research Infrastructure Roadmap for Kosovo.

ashtu siç është e domosdoshme. Për vitin 2023, kjo përqindje arrin vetëm 0.32%, duke u rritur gradualisht në 0.56% në vitin 2025, e cila prap se prap mbetet larg objektivit.

Alokimet buxhetore të përgjithshme për aktivitetet e planifikuara në PKSH për periudhën 2023-2028 pritet të jenë rreth 87 milionë euro. Në mesatare, gjatë këtyre gjashtë viteve, shuma e parashikuar është rreth 14.5 milionë euro në vit. Kjo nuk është në linjë me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve duke mos harmonizuar orientimet e PKSH-së. Si pjesë e PBB-së, financimi i K&I është gjithashtu i ulët, duke arritur 0.11% në 2023 dhe 0.16% në 2025, shifra që konsiderohen të pamjaftueshme për të mbështetur pjesëmarrjen në Hapësirën Evropiane të Kërkimeve dhe për të adresuar nevojat socio-ekonomike të vendit.³ Për të tejkaluar këtë situatë, është thelbësore të arrihet një konsensus institucional dhe shoqëror për rritjen graduale të investimeve në K&I. Ky proces duhet të synojë që brenda një periudhe prej 3-5 vitesh, investimet të arrijnë mesataren rajonale, duke krijuar kushte për zhvillimin e një ekosistemi të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt inovacionit.

Tabela 1 Kërkesat buxhetore për PKSH në raport me buxhetin dhe PBB

	2023	2024	2025
(A) Kërkesat buxhetore sipas viteve për aktivitetet e PKSH-së	10,272,500	15,326,750	17,918,925
(B) Buxheti	3,212,000,000	3,113,000,000	3,203,000,000
(C) GDP	9,621,300,000	10,407,800,000	11,156,400,000
(A)/(B) Proporcioni me buxhet	0.32%	0.49%	0.56%
(A)/(C) Proporcioni me GDP	0.11%	0.15%	0.16%

Në përpjekje për të nxitur zhvillimin e inovacionit dhe ndërmarrësisë, ligji për inovacionet është dorëzuar te Ministria e Financave, dhe ndodhet në fazën përfundimtare të miratimit. Ky ligj synon të krijojë një kornizë mbështetëse për inovacionin dhe ndërmarrësinë, duke siguruar fonde dhe përkrahje institucionale për projekte dhe ide të reja. Përkrah zhvillimit të kuadrove dhe inovacionit, ka mungesë të institucionalizimit apo agjencive të cilat në mënyrë strategjike dhe vizionare ndërtojnë një ekosistem dhe kontribuojnë sidomos tek zbatimi i politikave dhe strategjive.

Për më tepër, mbështetja për start-upet në Kosovë është aktualisht e fragmentuar dhe e shpërndarë mes disa institucioneve brenda ministrisë, gjë që shkakton konfuzion dhe tregon mungesë koordinimi nga ana e institucioneve vendore. Kështu, procesi mbështetet kryesisht në idetë inovative dhe politikat e hartuara nga ekspertë të jashtëm. Një shembull që ilustron këtë situatë është fondi për inovacion, i cili nuk ka përshkruar qartë rolin e sektorit privat dhe të Akademisë së Shkencave në këtë proces. Edhe pse fondi parashikon mbështetje të konsiderueshme për shkencë dhe inovacion, bashkëpunimi midis aktorëve kryesorë mbetet i paqartë. Institucionet e arsimit të lartë, përfshirë universitetet dhe shkollat profesionale, luajnë një rol kritik në fuqizimin e këtij ekosistemi.

Për të adresuar këto sfida, MINT ka hartuar Ligjin për Inovacion dhe Ndërmarrësi me qëllim të mbështetjes, promovimit dhe nxitjes së veprimtarive inovative me ndikim në ndërmarrje. Ky dokument ka kaluar nëpër një proces konsultimi paraprak dhe pritet të miratohet së shpejti nga qeveria dhe të dërgohet në procedurën parlamentare për miratim. Përfituesit e mbështetjes publike në këtë ligj janë 'entitetet dhe individët që kryejnë veprimtari inovative, me qëllim

³ Instituti Riinvest (2023). Mendimet dhe sugjerimet lidhur me draftin e Programit Kombëtar të Shkencës 2023-2028.

modernizimin e ekonomisë, zhvillimin dhe zbatimin e inovacioneve në produktet, shërbimet, prodhimin ose proceset'. Veprimtaritë që do të mbështeten nga ky ligj përfshijnë: veprimtari kërkimore dhe zhvillimore për veprimtari teknologjike; përgatitja e pajisjeve teknologjike dhe prodhimi për veprimtari inovative në sipërmarrje; analiza dhe testime sipas standardeve relevante, certifikimi dhe patentimi i produkteve inovative; krijimi i produkteve, shërbimeve dhe teknologjive të reja ose të përmirësuara në periudhën fillestare të projektit inovativ; transferimi i njohurive për produkte inovative; zhvillimi i infrastrukturës dhe mekanizmave për inovacionin; mbrojtja, transferimi dhe fitimi i të drejtave nga inovacionet; promovimi i rezultateve nga veprimtaria inovative dhe komercializimi i zgjidhjeve inovative.

Ligji për Inovacion dhe Ndërmarrësi përfshin dy mekanizma kryesorë: Fondin e Inovacionit dhe Këshillin Kombëtar për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Këshilli, si një organ këshillues i emëruar nga Qeveria dhe kryesuar nga Ministri, do të koordinojë politikat dhe masat për zhvillimin e inovacionit dhe rritjen e konkurrueshmërisë dhe do të përfshijë përfaqësues nga ministritë e linjës, shoqatat e biznesit, academia dhe sektorë të tjerë të lidhur me inovacionin. Roli i tij kryesor përfshin përcaktimin e prioritetëve strategjike, shpërndarjen e fondeve në përputhje me politikat qeveritare dhe rishikimin e raporteve mbi grantet dhe fondet për ministrinë përgjegjëse. Përveç këtyre, Këshilli do të japë mendime dhe rekomandime për programet e Fondit përpara se ato të miratohen nga qeveria, duke ndihmuar gjithashtu në koordinimin e politikave dhe veprimtarive të ndryshme për promovimin e inovacionit. Megjithatë, disa nga funksionet e këtij këshilli, veçanërisht ato që lidhen me menaxhimin operativ të Fondit të Inovacionit, mund të jenë më të përshtatshme për struktura të specializuara. Për këtë arsye, për të siguruar transparencë dhe profesionalizëm në proces, është e nevojshme krijimi i një bordi të pavarur, i përbërë nga ekspertë të fushës. Një qasje e tillë jo vetëm që fuqizon ekosistemin e inovacionit, por edhe kontribuon në zhvillimin e gjithanshëm të ekonomisë së vendit.

Në anën tjetër, Fondi i Inovacionit, i cili parashihet të krijohet brenda MINT do të shërbej si mekanizëm kyç për zbatimin e buxhetit dhe formave të tjera të mbështetjes, duke promovuar dhe stimuluar inovacionin për ndërmarrjet dhe individët me ide të reja. Financimi i fondit do të sigurohet nga burime të ndryshme, përfshirë buxhetin e Kosovës, institucionet financiare ndërkombëtare, programet ndërkombëtare për inovacione, investitorët privatë dhe kreditë e buta. Fondi do të mbështesë projekte inovative përmes skemave të granteve dhe kredive shtetërore. Mënyra e përdorimit të burimeve të financimit sipas paragrafit 3 të këtij Neni do të përcaktohet nga udhëzimet dhe programet e veçanta. Struktura organizative, detyrat, përgjegjësitë dhe mënyra e funksionimit të Fondit të Inovacionit do të përcaktohen me një akt të veçantë. Grantet nga burimet publike do të mbështesin kërkimet dhe zhvillimin e ideve, produkteve dhe shërbimeve inovative, promovimin e tyre, mbështetjen për institucionet që kontribuojnë në veprimtaritë inovative, produkte dhe shërbime, mbrojtjen e patenteve dhe të drejtat e pronësisë, certifikime dhe të ngjashme. Nga ana tjetër, kreditë shtetërore do të mbështesin zhvillimin e produktit, shërbimit ose procesit inovativ në fazat më të vona të zhvillimit, para hyrjes në treg, përmes pilotimit, demonstrimit, testimit dhe vërtetimit të produktit, shërbimit ose procesit inovativ dhe komercializimit të produktit, shërbimit ose procesit final.

Drafti i ligjit ka përcaktuar sektorët prioritarë si: Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK); mbrojtja e mjedisit dhe energjia rinovueshme, mjekësia dhe farmacia; promovimi dhe zhvillimi i turizmit; industri kreative dhe kultura; aktivitete për prodhimin dhe përpunimin e produkteve dhe shërbimeve për të gjitha industritë e tjera; dhe fusha të tjera që synojnë aplikimin e inovacioneve në ndërmarrje. Prioritetet duket të jenë mjaft fleksibël për të mos penguar sektorët e tjerë. Në vijim të praktikave të suksesshme nga vendet fqinje, ky ligj synon të inkurajoj pjesëmarrjen e NVM-ve dhe bizneseve të tjera në projekte që kërkojnë financim nga ky fond, duke integruar burimet e tyre financiare si një shtysë për investime të reja. Një qasje e tillë jo vetëm që do të forcojë angazhimin e sektorit privat në zhvillimin e inovacionit, por gjithashtu do të

kontribuojë në ndërtimin e një ekosistemi të qëndrueshëm dhe të integruar për kërkimet dhe zhvillimet në Kosovë. Përmes një qasjeje të koordinuar dhe vizionare, ky ligj ka potencialin të shndërrohet në një katalizator të fuqishëm për rritjen ekonomike dhe përmirësimin e konkurrueshmërisë në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

REKOMANDIME PËR FUQIZIMIN E EKOSISTEMIT TË INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË NË KOSOVË

Instituti Riinvest, duke u bazuar në të gjeturat më lartë rekomandon si vijon:

- Avancimin e mbështetjes institucionale të qëndrueshme dhe koordinim më të mirë ndërmjet institucioneve vendore për të nxitur inovacionin dhe ndërmarrësinë. Sfida si fragmentimi i mbështetjes për start-up-et dhe mungesa e agjencive të zbatimit duhet të adresohen. Roli i Akademisë dhe ekspertiza ndërkombëtare janë thelbësore për sigurimin e mentorimit cilësor dhe zhvillimin e projekteve inovative.
- Miratimi dhe përmirësimi i Ligjit për Inovacion dhe Ndërmarrësi: Ligji duhet të kalojë me kohë në procedurat parlamentare, duke përfshirë disa hapa kyç. Organizimi i dëgjimeve publike me pjesëmarrjen e ekspertëve dhe shoqatave të biznesit është i domosdoshëm. Ngritja e një bordi udhëheqës të Fondit të Inovacionit, i përbërë nga 5-7 anëtarë kryesisht ekspertë të pavarur, si dhe krijimi i një Komiteti ekspertësh me përvojë relevante dhe ndërkombëtare për vlerësimin e aplikimeve janë hapa të domosdoshëm. Po ashtu, duhet siguruar pjesëmarrja e organizatave të biznesit në financimin e projekteve të mbështetura nga Fondi i Inovacionit, duke përjashtuar start-up-et.
- Për të siguruar fillimin sa më të shpejtë të operacioneve të Fondit të Inovacionit, rekomandohet që MINT të nisë paralelisht me procedurat qeveritare dhe parlamentare zhvillimin e rregullativave dhe akteve ligjore të nevojshme. Kjo përfshin: konceptin e Fondit, rregullimin e strukturës organizative dhe menaxheriale, orientimin programor, si dhe politikat dhe procedurat për financimin dhe vlerësimin e projekteve. Këto hapa do të garantojnë një operacionalizim efektiv të Fondit dhe mbështetje të qëndrueshme për inovacionin dhe ndërmarrësinë.